

**Përmbajtja**

I - HYRJE	2
1. Titulli	2
2. Marrësi	2
3. Objektivat dhe qëllimi	2
4. Identifikimi i çështjes	2
5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	2
6. Përgjegjësitë e audituesve	3
7. Kriteret e vlerësimit	3
8. Standardet e auditimit	3
9. Metodatat e auditimit	3
10. Dokumentimi i auditimit	3
II - INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.	4
III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	5
III/1. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	6
III/2. Zbatimi i rekomandimeve për masat shpërblim dëmi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	10
III/3. Zbatimi i rekomandimeve për masat 3 E. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	10
III/4. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	11
IV - KONKLUZIONI I AUDITIMIT	11
V. GJETJET DHE REKOMANDIMET	12
A. MASA ORGANIZATIVE	12
B. MASA SHPËRBLIM DËMI	14
C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE	14
D. MASA DISIPLINORE	15
VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT	Error! Bookmark not defined.



I – HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 795/8 datë 07.09.2022 nga data 05.09.2022 deri në datën 24.09.2022, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021” për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Auditimi u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. M, Përgjegjës Grupi
2. L. K,
3. V. B,
4. R. K,
5. Sh. H,
6. R. A.

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet AKPT dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Titulli - Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar sipas programit nr. 931/1, datë 14.09.2021, të miratuar nga Kryetari i kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Marrësi – Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Tiranë.

3. Objektivat dhe qëllimi

Objektivat: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike.

Qëllimi: Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e auditimit.

4. Identifikimi i çështjes

Raporti ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitave ligjore në fuqi;
- planifikimin dhe zbatimin e buxhetit;
- zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile,
- zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet publike, si dhe zbatimi i kontratave;
- ndjekjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e procesit të hartimit dhe miratimit të planeve të përgjithshme vendore;
- vlerësimin e aktivitetit të bashkërendimit të punës së akpt me autoritetet vendore, në kuadër të proceseve të planifikimit të territorit.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.



6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë së kërkuar.

7. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar; Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr. 107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së; Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikën më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; VKM nr. 427, datë 8.6.2016 Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”; VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar; VKM nr. 881 datë 14.12.2016 Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, etj.

8. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

9. Metodatat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.

Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyës me përfaqësuesit e AKPT.



II - INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është autoritet me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Misioni i saj është të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të udhëhequr nga strategjitë e mirëplanifikuara dhe programet afatmesme e afgjata të zhvillimit; të sigurojë zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi që garantojnë mirëplanifikimin e territorit; si edhe të mbështesë dialogun profesional në fushën e planifikimit të territorit, duke përfshirë njohuritë e fituara gjatë eksperiencës në këtë fushë. Në këtë kuadër, AKPT harton, harton në bashkëpunim dhe bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, si dhe siguron bashkërendimin ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, si atë horizontal (mes institucioneve të pushtetit qendror), ashtu edhe atë vertikal (mes institucioneve vendore e qendrore). Gjithashtu, AKPT udhëheq, koordinon dhe ndërlidh veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në projektim urban dhe planifikim.

Baza Ligjore për krijimin e AKPT:

- Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe funksionon si institucion buxhetor. Burimet e financimit janë:

- a) të ardhurat e krijuara nga vetë Agjencia;
- b) buxheti i shtetit;
- c) donacionet, financimet e huaja dhe kreditë.

Veprimtaria buxhetore dhe financiare e AKP-së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) organizohet në nivel qendror dhe bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me çdo institucion publik të përfshirë në çështjet e planifikimit të territorit. Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika, si dhe numri i strukturave të varësisë miratohen nga Kryeministri.

Gjatë procesit të identifikimit të fushave me rëndësi për t’u audituar dhe me risk në drejtim të mosrespektimit të kuadrit rregullator dhe vulnerabel ndaj shkeljeve dhe korrupsion, konstatohet se në aspektin teknik nuk rezulton që AKPT-ja të ketë vendimmarrje të drejtpërdrejt në lidhje me ato veprime juridike mbi planifikimin e territorit, të cilat janë me risk dhe që realizohen kryesisht nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe KKT, siç është hartimi dhe miratimi përfundimtar i çdo plani që lidhet me zhvillimin e territorit.

Konkretisht, AKPT është përgjegjëse për:

- informimin e proceseve të përmirësimit të legjislacionit të planifikimit të territorit;
- administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të planifikimit të territorit, (Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit);
- informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit, si dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së tij gjatë proceseve të hartimit e zbatimit të dokumenteve të planifikimit;
- sigurimin e standardeve ligjore, teknike dhe metodologjike të fushës së planifikimit të territorit;
- ndjekjen, mbikëqyrjen dhe lëshimin e Akteve të Përputhshmërisë mbi hartimin e planeve territoriale të çdo lloji;
- hartimin e Raportit Vjetor Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave, të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare.

Duke qenë se roli i AKPT bën pjesë vetëm në një nga hallkat e gjithë procesit të hartimit dhe miratimit nga një sërë institucionesh publike në fushën e planifikimit të territorit është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË AKPT

vlerësuar që të përfshihet në auditim vetëm shqyrtimi i lëshimit të Akteve të Përputhshmërisë nga AKPT.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në përfundim të Auditimit, me shkresën nr. 931/7, datë 04.02.2022, të Kryetarit të KLSH-së, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 931/1, datë 14.09.2021, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2020.

Në zbatim të nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit nuk ka kthyer përgjigje brenda 20 ditëve, mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, është kthyer përgjigje për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH, me shkresën përcjellëse nr. 931/7 prot, datë 04.02.2022 janë lënë 20 rekomandime gjithsej, nga këto: 17 masa organizative, 1 masë zhdëmtimi në vlerën 3,230,000 lekë, 1 masë për eliminimin e efekteve financiare negative, në vlerën 15,416,666 lekë dhe 1 masë disiplinore për titullarin, nga "Vërejtje me paralajmërim" deri në "Largim nga Detyra". Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 17 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, janë në proces zbatimi 4 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime.

Për masa shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim në vlerën 3,230,000 lekë (i pa pranuar), i cili nuk është zbatuar.

Për eliminimin e efekteve financiare negative, është lënë 1 rekomandim në vlerën 15,416,666 lekë (i pa pranuar), i cili nuk është zbatuar.

Është lënë 1 masë disiplinore e cila nuk është zbatuar.

Nr	Emërtimi	Rekomandime në Numër				Nga rekomandime gjithsej sa me dëm ekonomik												
		Rekomandimin gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Nga Rekomandimet janë:											
			Zbatuar	Në Proces	Pa zbatuar	Pjesërisht	Rekomandimi me Gjithsej		Zbatuar			Zbatuar pjesërisht			Pa zbatuar			
							Persona	Në mijë Lek	Persona	Nr.	Lek	Në mijë Lek	Persona	Nr.	Lek	Persona	Nr.	Në mijë Lek
1	Masa për përmirësim ligjor																	
2	Masa Organizative	17	7	4	5	1												
3	Shpërblim Dëmi	1			1		8	3,230,000							8			3,230,000
4	Masa 3E	1			1													
5	Masa disiplinore	1			1													
	Totali	20	7	4	8	1												



III/1. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

Rekomandim 1:

Titullari i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe sektori përgjegjës për buxhetin, të marrin masa:

- të përcaktojnë qartë planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

-për hartimin dhe dërgimin periodik të raporteve të zbatimit të buxhetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për të gjitha periudhat e raportimit që përcaktohet nga kuadri ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Titullari i institucionit dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse, ka marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor, ku nëpërmjet hartimit të një plani pune, ka përcaktuar saktë kërkesat e secilit departament, kostot e produkteve të cilat evidentohen si domosdoshmëri referuar objektivave që ka vendosur institucioni, me qëllim realizimin dhe përdorimin me efikasitet të fondeve. Po kështu, Drejtoria e financës dhe shërbimeve mbështetëse ka dërguar në mënyrë periodike raportet e zbatimit të buxhetit pranë MFE.

Rekomandim 2:

Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, të marrë masa:

- për identifikimin dhe rekrutimin e punonjësve, plotësimin në kohë të nevojave dhe vendeve vakante të krijuara, sipas strukturës së miratuar dhe fondeve në dispozicion për këtë strukturë.

-për dokumentimin fizik zyrtar të njoftimit në dosjen e secilit person të rekrutuar të dhëna për vendin e punës, detyrat dhe përgjegjësitë, apo kriteret e kualifikimit. Njëkohësisht të marrë masa për të ndërhyrë nëpërmjet ekspertëve të fushës në përmirësimin e kapaciteteve të faqes ëeb në mënyrë që kjo e fundit të përballojë të gjithë volumnin e njoftimeve të vendeve vakante të publikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Sektori i Prokurimeve dhe Burimeve njerëzore ka bërë publikimin e vendeve vakante në faqen ëeb të AKPT <https://planifikimi.gov.al>. Vendet vakante janë dërguar për shpallje edhe pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Gjithashtu, në dosjet e secilit punonjës, bëhet dokumentimi fizik i të gjithë procesit të rekrutimit.

Rekomandim 3:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen, të informoje dhe ndjekë sipas ligjit të gjitha procedurat ligjore për debitorët e trashëguar, deri në likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në çdo rast të informojë mbi situatat financiare për të mos mbetur vetëm në pasqyrimin e tyre dhe kontabilizimi.

Menjëherë dhe në vijimësi



Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Drejtoria e financës dhe shërbimeve mbështetëse ka marrë masa për dërgimin e shkresave me lëndë “Rikujtesë për arkëtimin e detyrimit të prapambetur” drejtuar të gjithë debitorëve si vijon:

Shkresë nr. 1133, datë 26.07.2022 drejtuar E. B;

Shkresë nr. 1134, datë 26.07.2022 drejtuar L. Sh;

Shkresë nr. 1135, datë 26.07.2022 drejtuar K. L;

Shkresë nr. 1136, datë 26.07.2022 drejtuar D. L;

Shkresë nr. 1137, datë 26.07.2022 drejtuar I. H;

Në vijim, në rast të mos arkëtimin të këtyre detyrimeve, AKPT do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore administrative. Për detyrimet e prapambetura ndër vite për dy subjekte private, AKPT nuk disponon asnjë dokument financiar, për këtë arsye, arkëtimi është i pa mundur.

Rekomandim 4:

Titullari i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe sektori i financës të marrin masa për dokumentimin sa më të plotë dhe të njëpasnjëshëm të çdo veprimtarie që shkakton një shpenzim financiar në njësinë shpenzuese, duke rritur kërkesën e llogarisë ndaj palëve të kontraktuara për paraqitjen në formë të dokumentuar të gjithë kontributit të dhënë gjatë të gjithë periudhës së zhvillimit të projekteve me bazë konsulencën dhe jo vetëm pranimin e produktit përfundimtar.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Sektori i financës ka bërë dokumentimin e plotë dhe të njëpasnjëshëm të çdo veprimtarie që shkakton shpenzim financiar në njësinë shpenzuese, duke rritur kërkesën e llogarisë ndaj palëve të kontraktuara për paraqitjen në formë të dokumentuar të të gjithë kontributit të dhënë në zhvillimin e projekteve të konsulencës.

Rekomandim 5:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për procedura të ngjashme të realizimit të konkursit të projektimit, si fazë paraprake për lidhjen e një kontrate shërbimi, të përcaktojë qartë se kontrata e shërbimit të jetë vetëm hartimi i idesë përfundimtare, ndërsa për fazat e tjera si projekt-zbatimi, të përdorë procedurën e hapur.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

Rekomandim 6:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për raste të ngjashme, të përfshijë në vlerësimin e KVO-së masën në përqindje sesi anëtarët e BOE i plotësojnë kriteret teknike, profesionale, financiare etj.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Nga momenti i lënies së rekomandimit, nuk ka patur raste të pjesëmarrjes së BOE në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AKPT. AKPT do të zbatojë rekomandimin në vijim, në rastet e situatave me pjesëmarrje të BOE në konkurim.

Rekomandim 7:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për organizimin më efektiv të procedurave të prokurimit në rastet e emergjencave, ku për ato raste për të cilat njihet shtrirja



në kohë e procedurave, të realizojë paralelisht me procedurën shkresore edhe procedurën e prokurimit elektronik, në përfundim të të cilës të vijohet me lidhjen e marrëveshjes kuadër për shërbimet në vijim.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në të gjitha rastet në vijim në të cilat AKPT është ngarkuar si njësi zbatuese për hartimin e PdyV, është realizuar procedura në sistemin e prokurimit elektronik "Marrëveshje kuadër për procesin e rindërtimit", dhe konkretisht rekomandimi është zbatuar për procedurat vijuese:

REF-23082-03-25-2022

REF-23086-03-25-2022

REF-36765-07-21-2022

Rekomandim 8:

Në procedurat e prokurimit negocim pa shpallje, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për nxitjen e konkureshmërisë, duke përzgjedhur dhe ndërruar vazhdimisht operatorët ekonomik potencial që fton për të garuar.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Nga momenti i lënies së rekomandimeve, nuk ka patur raste të realizimit të procedurave të prokurimit të llojit "Negocim pa shpallje". Rekomandimi do të zbatohet nga strukturat përkatëse në procedurat e ngjashme në vijim.

Rekomandim 9:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për vlerësimin e kujdesshëm të kritereve të kualifikimit që paraqesin operatorët ekonomik, duke argumentuar dhe qartësuar në mënyrë konkrete arsyet e s,kualifikimit, si dhe të mos bëjë diferencime mes operatorëve në pikëzimin e secilit kriter, duke përdorur nën kritere të pa dakordësuara.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në procedurat e zhvilluara në vijim, strukturat përkatëse (KVO sipas rastit) kanë argumentuar dhe dokumentuar në mënyrë më të detajuar vlerësimin e tyre.

Rekomandim 10:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për çdo rast ku kërkohet rishikimi me procedurë të përshpejtuar, të pezullojë vendimmarrjen për aktin e përputhshmërisë kur konstaton se rishikimet e njëjësive strukturore prekin zona të mbrojtura apo zona historike si dhe pa përcaktuar afatet e takimeve të bashkërendimit dhe konsultimit publik.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

Rekomandim 11:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për rivlerësimin e ndryshimeve të propozuara për Planin e Përgjithshëm Vendor Shkodër, në përputhje me zonat e mbrojtura, deri në pezullimin e vendimit dhe nxjerrjen e përgjegjëseve.

Në vijimësi



Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

Rekomandim 12:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për të refuzuar çdo propozim për rishikim në lidhje me krijimin e vend-depozitimit të mbetjeve, i cili nuk është i harmonizuar apo në përputhje me dokumentet strategjike, veçanërisht kur këto ndryshime propozohet për njësitë strukturore N-natyre, buzë lumenjve.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

Rekomandim 13:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos plotësimin me dokumentacion standard analitik, të vlerësimit teknik të kryer mbi arsyet e dhënies së vendimit “në përputhje” dhe të shoqërojë me një relacion teknik në çdo vendim marrje lidhur me dokumentet e planifikimit të territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar pjesërisht dhe i zbatuar pjesërisht. Në procedurat e zhvilluara në vijim, grupet e punës kanë hartuar në mënyrë më të detajuar vlerësimin e tyre në Raportin e Vlerësimit Teknik. Megjithatë, rekomandimi nuk është zbatuar plotësisht, pasi AKPT nuk ka marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për mos plotësimin me dokumentacion standard analitik të vlerësimit teknik.

Rekomandim 14:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për monitorimin periodik të dokumenteve të planifikimit, me qëllimin vlerësimin e objektivave strategjike në raport me Planin e Përgjithshëm Kombëtar.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në kuadër të rekomandimit, me urdher nr. 9, datë 27.01.2022 të titullarit të AKPT, është ngritur grupi i punës për përgatitjen e raportit të monitorimit të zbatimit të PPV. Raporti i monitorimit i përgatitur nga ky grup pune, është prezantuar edhe në mbledhjen e datës 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Rekomandim 15:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në mungesë të një reference ligjore në lidhje me distancat ujore, të pezullojë miratimin e ndryshimeve të njësisive strukturore pranë brigjeve, deri në miratimin e kuadrit të ri ligjor mbi distancat nga brigjet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

**Rekomandim 16:**

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masa për shqyrtimin e kontratës me kompaninë që ka krijuar Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit dhe gjenerimin e ndryshimeve apo përmirësimeve të nevojshme në mënyrë që ky regjistër të jetë plotësisht i dobishëm dhe funksional sipas parashikimeve dhe hapave që përcakton VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht. Në përfundim të ngritjes së të gjithë ëorkfloë në bashkëpunim me AKShI-n, në sistemin elektronik E-planifikimi, i cili do të zëvendësojë totalisht Regjistrin dhe do të konsiderohet Regjistri i ri, do të bëhet e mundur që ndërveprimi insitucional gjatë procesit të hartimit të planeve, të realizohet i plotë nëpërmjet Regjistrit. Me shkresën nr. 1082, datë 12.07.2022 “Kërkesë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisje TIK”, i është kërkuar AKShI-t realizimi i procedurës së prokurimit me objekt “Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit për AKPT”.

Rekomandim 17:

Deri në zgjidhjen e përdorimit plotësisht funksional të Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për dokumentimin e të gjithë hapave, korrespondencave dhe çdo komunikimi tjetër që lidhet me hartimin e një plani territorial, në formë shkresore dhe kronologjike.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Çdo bashkërendim që lidhet me hartimin/rishikimin e dokumenteve të planifikimit, gjendet i dokumentuar në formë shkresore dhe i publikuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

III/2. Zbatimi i rekomandimeve për masat shpërblim dëmi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

Rekomandimi 1:

Titullari i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës prej 3,230,000 lekë nga 38 ekspertët për të cilët nuk ka asnjë evidencë të angazhimit të tyre në projekt.

Brenda Mars 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

III/3. Zbatimi i rekomandimeve për masat 3 E. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021” NË AKPT

Rekomandimi 1:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për çdo procedure prokurimi të përfshijë një relacion mbi vlerësimin e efektivitetit të fondeve të shpenzuara, në përfundim të zbatimit të kontratës dhe marrjes në dorëzim të produktit/shërbimit përkatës.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

III/4. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

Rekomandimi 1:

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Kontratës Individuale, i rekomandojmë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, sipas kompetencave përkatëse, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga detyra”, për:

1. Znj. A. G, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

- Për mangësitë e konstatuara në procedurën e realizimit të nismës “Akademia 100+ fshatrat”,
- Për mangësitë e konstatuara në procedurën e prokurimit të “Projektit të zbatimit për Shkollën e Magjistraturës”,
- Për mangësitë e konstatuara për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për ndryshimet e propozuara në PPV Shkodër, si dhe
- Për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore;

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pa pranuar dhe i pa zbatuar. Rekomandimi nuk pranohet duke ju referuar përsëri observacioneve të dërguara me shkresat nr. 1250/2, datë 22.11.2021 dhe nr. 29, datë 06.01.2022.

IV - KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 20 rekomandime gjithsej, nga këto: 17 masa organizative; 1 masë shpërblim dëmi, 1 masë për eliminimin e efekteve financiare negative, si dhe 1 masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga detyra”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes nga 17 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 7 rekomandime, janë në proces zbatimi 4 rekomandime, është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime.
- b. Për masa shpërblim dëmi është lënë 1 rekomandim në vlerën 3,230,000 lekë (i pa pranuar), i cili nuk është zbatuar.
- c. Për eliminimin e efekteve financiare negative, është lënë 1 rekomandim në vlerën 15,416,666 lekë (i pa pranuar), i cili nuk është zbatuar.
- d. Është lënë 1 masë disiplinore e cila nuk është zbatuar.



V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt prokurimi “Projekt-zbatimi për godinën e Shkollës së Magjistraturës”, në konkursin e projektimit të vitit 2015, ku është tenderuar projekt-ideja paraprake është shpallur fitues bashkimi i operatorëve S &V dhe PRG*B, ndërsa në tenderin e vitit 2018 objekt shqyrtimi, procedura negociim pa shpallje paraprake të njoftimit është bërë me bashkimin e operatorëve “K+S V+V”, duke përfshirë një subjekt të tretë K sh.p.k që nuk ka qenë i përfshirë në procedurat konkurruese të tenderit fillestar. Për më tepër, nga ana e Autoritetit Kontraktor, procedura me negociim pa shpallje paraprake të kontratës është zhvilluar me 1 kandidat (BOE), ndërkohë që sipas nenit 34/4 të VKM 914/2017, objekti i prokuruar “projekt zbatimi” nuk njihet si procedure që duhet të lidhet me 1 kandidat. Si pasojë, tenderi i vitit 2015 duhet të kishte përcaktuar lidhjen e kontratës së shërbimit vetëm për projekt-idenë përfundimtare jo për shërbimin e projekt zbatimit, e cila i përket një sferë apo objekti tenderues që nuk lidhet me të drejtën ekskluzive, për sa kohë kërkohen specifitime të tjera ligjore, teknike dhe profesionale, përfshirë licencat të ndryshme nga ato që kërkohen për projekt-idenë. Në lidhje me fazën e vlerësimit të ofertës është konstatuar se BOE e shpallur fitues K+S-V+PGR*B nuk plotëson kriteret ligjore, teknike, ekonomike dhe profesionale të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për procedura të ngjashme të realizimit të konkursit të projektimit, si fazë paraprake për lidhjen e një kontrate shërbimi, të përcaktojë qartë se kontrata e shërbimit të jetë vetëm hartimi i idesë përfundimtare, ndërsa për fazat e tjera si projekt-zbatimi, të përdorë procedurën e hapur.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimi të Territorit ka pranuar rishikimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër me procedurë të përsheptuar, duke mos zbatuar plotësisht dispozitat ligjore. Me shkresën nr. 16906 datë 19.11.2020 Bashkia Shkodër ka dërguar kërkesën për pajisje me akt-përputhshmërie në kuadër të rishikimit të planit të përgjithshëm vendor. Kjo nismë rishikimi parashikon ndryshimin e sipërfaqeve dhe njësive strukturore, përfshirë zona buzë liqenit, zonat e mbrojtura dhe të trashëgimisë kulturore. Nga vetë Agjencia Kombëtare e Planifikimi të Territorit janë identifikuar rreth 15 raste të kësaj nisme për rishikim që prekin peizazhin e mbrojtur “Lumi Bunës-Velipojë”, Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”, zonën historike të qytetit të Shkodrës.

Rishikimi i planit të përgjithshëm vendor me procedurë të përsheptuar është në kundërshtim me VKM nr. 682/2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” të ndryshuar, neni 11 pika 4 /a, ku procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit për çështje që nuk cenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore.

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për çdo rast ku kërkohet rishikimi me procedurë të përsheptuar, të pezullojë vendimmarrjen për aktin e përputhshmërisë kur konstaton se rishikimet e njësive strukturore prekin zona të mbrojtura apo zona historike si dhe pa përcaktuar afatet e takimeve të bashkërendimit dhe konsultimit publik.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimi të Territorit ka miratuar aktin e përputhshmërisë për propozime që prekin zona të mbrojtura dhe zona historike, ku ndonëse më shkresën nr. 1270/05 datë 04.12.2020 ka njoftuar Bashkinë Shkodër se pas marrjes së përgjigjes bashkërenduese nga institucionet e mësipërme, do t’i përgjigjet zyrtarisht për lëshimin e aktit të përputhshmërisë, ky akt është lëshuar pa marrë përgjigjen nga institucionet përkatëse. Nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021” NË AKPT

auditimi rezultoi se janë miratuar ndryshimet në njësitë strukturore, duke ndryshuar përdorimin e tokës nga N-Natyrore në S-shërbime dhe sipërfaqet përkatëse, ndër të cilat, lidhur me:

- VL.001.N, territore të Peizazhit të mbrojtur “Lumi i Bunës-Velipojë”, me sipërfaqe 1.042.308.13 m² ndryshon në 718,273.82 m², duke zbritur sipërfaqen 324,035 m².
- VL014-N, me sipërfaqe totale 5,692,940 m² ndryshon në, 5,609,104 m², duke zbritur sipërfaqen 83,836 m²;
- Zgjerimi i VL137N drejt VLN136 N, duke zgjeruar sipërfaqen nga 1,478,428 në 1,486,644 m.²
- Është krijuar njësia VL012/1UB brenda zonës së mbrojtur, me sipërfaqe 331,393 m2 me përdorim toke S-Shërbime, duke e përcaktuar si derivat të njësisë strukturore VL012.UB.
- Zona historike e qytetit të Shkodrës, pasaporta e njësisë strukturore SH001.UB , është ndryshuar sipërfaqja e përgjithshme nga 223,810 m2 në 218,771 m2, pa përfshirjen e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Ndryshimi i kufijve të zonës historike është bërë duke ndryshuar edhe njësitë strukturore fqinje, nga SH002-SH010, që i përkasin qytetit të Shkodrës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 682/2017, neni 36 “Autoriteti përgjegjës për ndërmarrjen e nismës, sipas pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, është ministri përgjegjës për zonën/çështjen përkatëse të rëndësisë kombëtare ose autoriteti përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel qendror, në rastet e përfshirjes së disa sektorëve. Ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, neni 44 që përcakton se dokumentet e planifikimit, që kanë lidhje specifike me zhvillimin e zonave të rëndësisë kombëtare të trashëgimisë, termat e referencës për hartimin e tyre dhe dokumentet finale vlerësohen, paraprakisht, nga KKTKM-ja. Ndryshime të tilla veçanërisht sa i përket reduktimit të sipërfaqeve të zonave me rëndësi kombëtare nuk janë në përputhje me objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe Strategjinë ndërsektoriale të mjedisit 2015-2020 ku është parashikuar si objektivi rritja me 17% e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura.

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për rivlerësimin e ndryshimeve të propozuara për Planin e Përgjithshëm Vendor Shkodër, në përputhje me zonat e mbrojtura, deri në pezullimin e vendimit dhe nxjerrjen e përgjegjësi.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka miratuar propozimin e Bashkisë Shkodër për krijimin e një vend-depozitimi mbetjesh të ngurta dhe shtimin e kategorisë infrastrukturë menaxhim mbetjesh në pasaportën e njësisë strukturore RRE084-N(natyrë), e cila nuk është parashikuar në dokumentet e tjera strategjike. Sipas shkresës nr. 1270/07 prot, datë 17.12.2020 Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka kontrolluar dokumentet dhe strategjitë që lidhen me këtë çështje dhe ka konstatuar se nuk përmendet apo parashikohet ngritja e një infrastrukture të tillë(vend-depozitimi mbetjesh inerte) në zonën referuar apo pranë saj.

Ky propozim nuk është i parashikuar në Strategjinë territoriale, Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Planin e Menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Shkodër, Plani kombëtar Sektorial i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta.

4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa për të refuzuar çdo propozim për rishikim në lidhje me krijimin e vend-depozitimit të mbetjeve, i cili nuk është i harmonizuar apo në përputhje me dokumentet strategjike, veçanërisht kur këto ndryshime propozohet për njësitë strukturore N-natyrë, buzë lumenjve.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Me shfuqizimin e kufijve dhe shtrirjes së brigjeve me ligjin nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021” NË AKPT

burimeve ujore” duke i bërë një përkufizim të ri “brigjeve”, pa distancat përkatëse të shprehura në njësinë metra, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit pengohet që të bëjë një vlerësim objektiv dhe me referencë ligjore, për planet vendore që përcaktojnë njësi strukture buzë ujërave. Në rastin e Bashkisë Shkodër, me shkresën nr. 1400/1 prot datë 17.12.2020, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka dhënë mendim ndër të tjera se “në respektim të parashikimeve të mësipërme (lidhur me draft-vendimi e përcaktimit të distancave nga brigjet etj), si dhe faktit që në nenin 5 të ligjit 111/2012 përcaktohet se “të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrrenjve...,liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrore dhe artificiale...janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore, vlerësojmë se në përcaktimin e kufijve të njësive strukturne duhet të përmbushet kushti që kufijtë e njësive të mos përshkojnë zonën dhe gjerësinë e bregut të liqenit (kriteret sipas draft-vendimit për zonën dhe gjerësinë e bregut në liqenore” Si rrjedhojë, ende distancat nuk janë të përcaktuara me një akt-ligjor. Mungesa e distancave sjell rrisht për cenimin e brezit ujore, detar, liqenor etj.

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në mungesë të një reference ligjore në lidhje me distancat ujore, të pezullojë miratimin e ndryshimeve të njësive strukture pranë brigjeve, deri në miratimin e kuadrit të ri ligjor mbi distancat nga brigjet.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Më datë 27.09.2018, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi me 38 ekspertë staf akademik nga UBT dhe FE. Nga auditimi rezultoi se të gjithë ekspertët e mësipërm janë paguar në vlerën dhe numrin e ditëve të përcaktuara në VKM, në rolin e Udhëheqësve rajonal, por nuk gjendet e dokumentuar as nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe as nga UBT dhe FE (ekspertët janë dërguar vetëm nga këto dy institucione akademike) një analizë mbi numrin e nevojshëm të tyre, apo për cilin fshat dhe në cilën fushë aktiviteti nevojiteshin ata. Referuar nenit 4 të kontratave të lidhura me ekspertët, rezulton se detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertëve janë si vijon:

Eksperti ofron opionencë të specializuar në fushën e ekspertizës përkatëse;

Eksperti asiston grupin e punës për identifikimin e të gjithë elementëve të fshatit brenda kornizës së zhvillimit të turizmit rural;

Eksperti ofron opionencë mbi raportet e gjetjeve të hulumtimit të bërë nga grupi i punës, si dhe mbështetje lidhur me paketën e gjerë të potencialeve të fshatrave;

Eksperti siguron pjesëmarrjen në konferenca, seminare dhe veprimtari të tjera dhe ofron raporte vlerësimi në ndihmë të grupeve të punës

Eksperti siguron pjesëmarrjen për organizimin e tryezave të punës profesionale dhe konferencave me interes për këtë akademi.

Nga sa më lart rezultoi se detyrimet e kontratës nuk janë përmbushur nga asnjë prej ekspertëve. Bashkëlidhur likuidimeve nuk gjendet asnjë dokument justifikues apo faktues në formën e produktit të punës së këtyre grupeve gjatë këtij angazhimi 10 ditor.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës prej 3,230,000 lekë nga 38 ekspertët për të cilët nuk ka asnjë evidencë të angazhimit të tyre në projekt.

Brenda Mars 2022

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “projekt-zbatim i godinës së Shkollës së Magjistraturës” konstatohet shpenzim pa efektivitet, në vlerën 15,416,666 lekë. Në zbatim të VKM Nr. 234, datë 17.04.2019 “Për Programin e Integruar të Zhvillimit “Poli i Drejtësisë” dhe Urdhrit Nr. 90, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, datë 14.05.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021” NË AKPT

“Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e fazës së parë të programit të integruar të zhvillimit “Poli i Drejtësisë”, drejtuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoriteti përgjegjës për projektimin dhe zbatimin e punimeve për ndërtimin e godinave dhe të infrastrukturës mbështetëse të Polit të Drejtësisë, ku bën pjesë edhe Shkolla e Magjistraturës, është ndryshuar vendndodhja e godinës së shkollës. Si rrjedhojë, ky objekt nuk do të ndërtohet sipas përcaktimeve të projektit të zbatimit, produkti i tenderit, (vendndodhja ka ndryshuar etj) si dhe tanimë kjo shkollë vazhdon aktivitetin në një godinë tjetër.

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të marrë masa që për çdo procedurë prokurimi të përfshijë një relacion mbi vlerësimin e efektivitetit të fondeve të shpenzuara, në përfundim të zbatimit të kontratës dhe marrjes në dorëzim të produktit/shërbimit përkatës.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Kontratës Individuale, i rekomandojmë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, sipas kompetencave përkatëse, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga detyra”, për:

1. Znj. A. G, me detyrë Drejtor Përgjithshëm Agjencisë Kombëtare Planifikimit Territorit.
 - Për mangësitë e konstatuara në procedurën e realizimit të nismës “Akademia 100+ fshatrat”,
 - Për mangësitë e konstatuara në procedurën e prokurimit të “Projektit të zbatimit për Shkollën e Magjistraturës”,
 - Për mangësitë e konstatuara për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për ndryshimet e propozuara në PPV Shkodër, si dhe
 - Për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT